

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Riparimi i Transformatorëve deri 1.8 MVA per tension TM/TU.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Transformatore te Shperndarjes

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontrates: 194,590,200 (njëqind e nentëdhjetë e katër milion e pesëqind e nentëdhjetë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH ose 2,073,417.15 (dy milion e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë pike pesëmbëdhjetë) Euro.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 06/07/2026 është 93.85 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Autoriteti/enti Kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Tirane” ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyesimit te meposhtem:

Objekti i kesaj procedure konsiston ne Riparimin e Transformatoreve te fuqise deri ne 1.8 MVA, magazinimi dhe terheqja sipas nevojave te OSSH sh.a. Vendndodhja e transformatoreve te fuqise per te cilet do te ofrohet ky sherbim eshte ne gjithe territorin e Shqiperise.Autoriteti kontraktor, merr persiper transportin e transformatoreve nga vendodhja e tyre deri ne Repartin e riparimit te operatorit ekonomik fitues dhe anasjelltas. Koha per kryerjen e riparimit te transformatoreve nuk do te tejkaloje afatin maksimal prej 60 ditesh kalendarike, nga data e dorezimit te transformatorit ne repart. Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktor mbajne pocesverbal per konstatimin e difekteve

te mundshme te transformatorit te demtuar dhe ne perfundim te kryerjes se sherbimit transformatori i riparuar duhet te jete nenshtuar testeve te matjeve, etj dhe te mbahet akti i kolaudimit.

Ne momentin e dorezimit te transformatorit midis paleve duhet te mbahet edhe proces verbali i dorezimit.

Per sa mesiper dhe per te shmangur shume procese qe mund te lindin, kjo procedure nuk eshte e mundur te ndahet ne lote por duhet te behet nga nje OE per arsyje dhe te garancise se defektit.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP te ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit në procedurën e prokurimit

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP të ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vlera e fondit limit të përcaktuar është një vlerë në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Vlera e përcaktuar e xhiros i shërben autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Objekti i kësaj kontrate konsiston në “Riparimi i Transformatorëve deri 1.8 MVA për tension TM/TU”, ku transformatorët konsiderohen pajisje teknologjike delikate dhe të domosdoshme për shërbimin normal të rrjetit të shpërndarjes.

Duke marrë në konsideratë për sa më sipër, ku theksohet rëndësia e këtij shërbimi, gjithashtu duke marrë në konsideratë vlerën e parashikuar të Marreveshjes Kuader e cila na kalon në “Procedure mbi kufirin e lartë monetar”, afatet e të cilës shtrihen në kohë, në mënyrë që autoritetit/entit kontraktor të njohë gjendjen financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, për të mundësuar konkurrencë gjithëpërfshirëse, është përcaktuar dhe vlera e mësipërme.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.”

Ky kriter siguron që operatorët ekonomikë që marrin pjesë kanë kapacitetin financiar për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë të sigurtë dhe të efektshme. Ky është i rëndësishëm për të shmangur situata ku operatorët nuk plotësojnë kapacitetin financiar dhe nuk mund të përfundojnë shërbimin.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025**, të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të **Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe Ligjit nr.126/2024, neni 22** “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009 si dhe me *Ligjin nr.126/2024* : “*Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii.ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.*

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (**të vitit 2026**) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.).

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

*** Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/et lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në Shtojcën përkatëse të DST.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriterë janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % vlerës së përlogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat perkatese të vlefshme të ISO-ve të lehuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001: 2015 për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente (të vlefshme)
- ISO 14001: 2015 për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ose ekuivalente (të vlefshme)
- ISO 45001: 2018 për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë ose ekuivalente (të vlefshme)

*** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Shënim: Për certifikatat e mësipërme Operatorët Ekonomikë ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon këto certifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto certifikata janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 44, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar,

Kërkesa lidhur me çertifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE I interesuar është në

gjëndje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mire të cilësisë.

Kërkesa lidhur me certifikimin ISO 45001:2018 ose ekuivalent, është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit. Natyra e këtij shërbimi lidhet direkt me procese të vështira pune me makineri të renda, të cilat mund të sjellin pasoja për shëndetin dhe sigurinë e punonjësit.

Kërkesa lidhur me certifikimin ISO 14001:2015 ose ekuivalent, pasi operatori ekonomik duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i shërbimit për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha shërbimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës, ku përfshihet edhe minimalisht një inxhinier elektrik i pajisur me Diplome.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- kartelat perkatese të sigurimit teknik
- Listepagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për per **muajin** e fundit të *deklaruar* të konfirmuara nga administrata tatimore
- Për inxhinierin pjesë e stafit të cilet duhet detyrimisht të jenë të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë për periudhën e mesiperme, duhet të paraqitet kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të shërbimeve për këtë objekt si edhe diplomë + CV

Për të përmbushur këtë kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në konsideratë të përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Me qellim realizimin e shërbimeve sipas termave të references dhe në kohe, nevojitet staf për të realizuar të gjitha stadet e punës gjatë procesit të riparimit të transformatoreve. Mendojmë se kërkesa prej 15 punonjësish është një kërkesë e arsyeshme kjo në raport me etapat e punës dhe me numrin e transformatoreve që pritet të riparohen. Në total pritet të riparohen rreth 880 Transformatore të tipeve të ndryshme, në të cilat do të kryhen proceset e:

1. Matja e rezistencës ohmike të peshtjellave (gabimi max +10%);
2. Matja e rezistencës së izolimit të peshtjellave;
3. Matja e koeficientit të transformimit dhe grupit të lidhjeve (tolerance $\pm 0.5\%$ të koeficientit të deklaruar);
4. Prova e punimit pa ngarkesë;
5. Prova e lidhjes së shkurtër;
6. Prova me tension të rritur (24 kV për TM dhe 3 kV për TU);
7. Matja e rrymave të rrjedhjes;
8. Prova e vajit (pas rigjenerimit të tensioni i cilit të arrijë normën 35-40 kV);
9. Matja e qëndrueshmërisë elektrike të vajit;
10. Matja e humbjeve me dhe pa ngarkesë.
11. Specifikimet teknike të vajit të ri të transformatoreve
12. Specifikimet teknike të tipeve të transformatoreve sipas fuqisë dhe tensionit

Dhe të gjitha proceset e percaktuara në preventiv, stafi i mesiperm është i nevojshëm.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Bango për montimin e nukleve të transformatoreve (kryen assemblimin e fleteve të nuklit me saktësi)
- Bobinatrice për avolzhimin transformatorësh me flete alumini dhe bakri (kryen përgatitjet e peshitjellave sekondare dhe primare të transformatoreve)
- Bobinatrice për avolzhim transformatorësh me tel bakri dhe alumini (kryen përgatitjet e peshitjellave sekondare dhe primare të transformatoreve)
- Filter prese për pastrimin e vajit të transformatoreve; (kryen filtrimin mekanik të vajit)
- Filter vakum për pastrimin kimik të vajit të transformatoreve me kapacitet deri në 6000 lit /ore; (kryen filtrimin kimik dhe heqjen e lageshtirës së vajit)
- Furrë elektrike të montuar në fabrike; (bën tharjen e bobinave sekondareve , primare , nukleve, dhe aksesoreve të transformatoreve)
- Mjet ngrites (pirun) deri 2.5 ton. (shërben për levizjen e e peshave të rënda brenda dhe jashtë repartit)
- Pajisje saldimi për hekur, baker dhe alumini; (kryen shërbimin e saldimit të zbarave të aluminit dhe bakerit me TIG)
- Tranxhe metalike; (shërben për prerjen e llamarinave dhe kartonave)
- Trapano kolone ; (shërben për hapjen e vrimave sipas nevojave)
- Tronkatrice për prerjen nukleve 45 grade;
- Vinc elektrik minimumi 2.5 ton i montuar në repartin e riparimit të transformatoreve (në ofiçinë), që shërben për hapjen dhe mbylljen e transformatoreve gjatë riparimit.
- Makineri për përpunim teli gjatë procesit të avolzhimit .(shërben për procesin e thurjes së bobinave të bakerit dhe aluminit)
- Paisje për matjen e humbjeve të transformatoreve pa ngarkesë dhe lidhjes së shkurtër.
- Paisje për testimin e transformatoreve me tension të aplikuar deri në 100 kV
- Paisje për testimin e transformatoreve me tension të induktuar dyfish (2Un) dhe frekuencë dyfish (100 Hz).
- Paisje për matjen e tensionit të shpimit të vajit të transformatoreve deri në 80 kV.

Operatori ekonomik duhet të vertetojë pronesinë e makinerive / pajisjeve të mesiperme nepermjet faturave tatimore të blerjes, kontrate blerje, kontrate dhurimi apo cdo forme tjetër e fitimit të pronesisë sipas kodit civil, ose nepermjet deklarates noteriale të shoqëruar me fotografite të makinerive / pajisjeve,

ose nepermjet kontrates se qirase per makinerite / pajisjet e marra me qira, e cila duhet te shoqerohet me aktin e pronesise mbi makinerite / pajisjet qe merren me qira.

Në konsideratë te përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Bazuar ne eksperiencen e kontratave te meparshme per realizimin e ketij sherbimi nevojiten makinerite dhe pajisjet e sipercituara.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi (provuar kjo me dokumentacion pronesie, me nje nga format e pronesise te parashikuar ne Kodit Civil) ose me qira (provuar me kontrate qiraje para noterit) nje ambient me siperfaqe jo me te vogel se 500 (peseqind) m² objekt, per ofrimin e sherbimit te riparimit te trasformatoreve dhe nje siperfaqe te lire jo me te vogel se 1000 (nje mije) m² per ruajtjen dhe magazinimin e trasformatoreve, qe do te riparohen.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit *siperfaqja prej te pakten 500 m², e cila eshte e domosdoshme pasi mundeson ofrimin e sherbimit te riparimit te trasformatoreve dhe nje siperfaqe te lire jo me te vogel se 1000 (nje mije) m² per ruajtjen dhe magazinimin e trasformatoreve qe do te riparohen.*

Procesi i tharjes se transformatoreve ne furrat elektrike (Furrat elektrike duhet te kene siperfaqe mbi 20m katror).

Procesi i magazinimit te brendshem dhe te jashtem.

Procesi i provave elektrike dhe kolauditimit perfundimtar.

Procesi i ngarkimit dhe shkarkimit te transformatoreve ne ambientet e jashtme dhe te brendshme te repartit. Proces i cili kerkon hapesirat e nevojshme per levizjen e mjeteve te tonazheve te ndryshem.

Ne baze te parashikimit te bere, brenda nje viti kalendarik parashikohet qe te riparohen 880 transformatore dhe mendohet qe ne ambientet e repartit te riparimit, do te magazinohen cdo muaj 60-70 transformatore te tipeve te ndryshem. Po keshtu ambienti duhet te jete funksional ne lidhje me hapesirat qe duhe te kete per levizjen e mjeteve te cilat do te perdoren per transportimin dhe zhvendosjen e transformatoreve.

Per sa me siper mendojme se hapesira e kerkuar eshte e nevojshme.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Në specifikimet teknike, nuk përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Shënim:

Specifikimet teknike jane hartuar nga OSSH sh.a qender dhe jane derguar me e- mail ne Drejtorine Rajonale Tirane e OSSH sh.a. Fondi Limit , afati i levrimit, termat e refernces jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.

- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë:

Data 10.08.2026 Ora 11.00

Vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

Njesia e Prokurimit